



# Një ditëlindje më ndryshe!

Për klasën e katërt të arsimit fillor



# Një ditëlindje më ndryshe!

## **Fjalët kyçe:**

planifikimi, buxheti, buxhet personal, buxhet familjar, buxheti grupor

## **Udhëzime për punë me librin.**

### **Para leximit: Bisedë me fëmijët:**

- Cila është ëndrra juaj që dëshironi ta realizoni?
- Si do ta realizoni atë?
- Keni planifikuar shpenzimet për të realizuar ëndrrën tuaj?

### **Gjatë leximit: Bisedë me fëmijët:**

- Nxitni fëmijët të flasin për atë çfarë shohin në ilustrim.
- Përdorni pyetjet: Çfarë po shihni? Pse është....? Ku ...? etj.
- Pas çdo faqeje të lexuar bisedoni për atë se çfarë ka ndodhur.
- Nxitni fëmijët të parashikojnë se çfarë do të ndodhë në faqen tjetër pa e shfletuar ende.
- Kërkoni nga fëmijët që të gjejnë fjalë të ngjashme me disa nga fjalët e reja në tekst.

### **Pas leximit: Bisedë me fëmijët:**

- Shih faqen 3 dhe trego: Pse ishte i mërziur Pupu?
- Shih faqen 4 dhe 5 dhe trego: Prej nga i erdhi Pupus ideja për dhuratën e ditëlindjes?
- Shih faqen 10 dhe 11 dhe trego: Si e pritën dëshirën e Pupus prindërit?
- Shih faqen 12 dhe 13 dhe trego: A i kishte planifikuar shpenzimet që do t'i bënte për ditëlindje Pupu?
- Çfarë do të ndodhte nëse Pupu dhe prindërit nuk do të planifikonin buxhetin e familjes dhe atë personal?
- A keni edhe ju ndonjë dëshirë sikurse Pupu, dhe si do ta realizoni atë?
- Detyrë: Harto buxhetin personal për një vit me ndihmën e prindërve.








**Çfarë ka Pupu? Për çfarë po mendon ai? Duket sikur po ëndërron me sy hapur. Ditëlindja e tij po afrohej...**



# PRAGA

Në esenë në lëndën e gjuhës shqipe me temën “Ku dëshiroj t'i kaloj pushimet dimërore”, Pupu kishte shfaqur dëshirën e tij për të vizituar qytetin e Pragës. I frymëzuar nga fotografitë që kishte hulumtuar, mësuesja, shokët dhe shoqet e klasës, kishin mbetur të mahnitur me përshkrimin që i kishte bërë Pupu pamjeve të qytetit të mbuluar me borë.





- Praga me të vërtetë është një ndër qytetet më të bukura, sidomos gjatë stinës së dimrit, - kishte pohuar mësuesja.  
Pupu ishte shumë krenar me veten në ato çaste.












**Pupu, tani i shtrirë, po imagjinonte sikur ishte duke shetitur rrugëve të Pragës, të tëra të mbulura me dëborë.**

- Pupu çfarë ke bir? - ia ndërpreu mendimet nëna.
- Ëëë... asgjë nënë, - u përgjigj shpejt ai.
- Si asgjë? Ti nuk ke lëvizur tërë paraditën! - tha nëna me habi.
- Më fal nënë, nuk mund të ta them tani, - u përgjigj me zë të ulët

**Pupu.**

**Për pak çaste nëna mbeti gojëhapur duke e shikuar por nuk tha asgjë!**





- Më fal nënë, unë... unë, nuk di si të ta them - vazhdoi Pupu me zë të ndrojtur.







- Unë kam një dëshirë të madhe. Dhe ajo mund të mos realizohet, - u përgjigj me dyshim Pupu.
- Hëëë... pa ma trego njëherë dëshirën tënde, o Pupu, - i fliste me durim nëna.
- Dua të shkoj në Pragë për ditëlindje, - foli Pupu me zërin që i dridhej.
- Pragë! Kush don të shkoj në Pragë? Atje tani është dimër, - pyeti babai.
- E di, e di, por unë... e dua borën, - u përgjigj shpejt Pupu.
- E di që kjo është jashtë planifikimit të buxhetit familjar, por unë kam kursyer mjaft para dhe ato janë në bankë, - shpjegonte shpejt Pupu. Nëna dhe babai u shikuan me habi.





- Po, po. Ju më keni mësuar qysh moti që për t'i realizuar dëshirat duhet të filloj të kursej sa më herët. Prandaj unë e kam planifikuar buxhetin mujor por dhe atë vjetor. Kam kursyer mjaft mirë nga të hollat javore që më keni dhuruar ju, pastaj nga të hollat që i kam fituar me punët shtesë në familje. I kam larguar edhe disa shpenzime të panevojshme nga lista.

Nëna dhe babai mbetën të habitur nga serioziteti që po tregonte Pupu për buxhetin personal.





- Në rregull pra. Të shohim si do t'ia bëjmë kësaj pune. Ti nuk mund të udhëtosh vetëm Pupu, - shtoi babai me mëdyshje.
  - Por babi, Lea, vajza e mikut tënd, më ka treguar, që babi i saj është këtu dhe ai do të kthehet së shpejti në Pragë, - foli Pupu me një frymë.
  - Ha, ha, ha, i paske menduar të gjitha ti. Do ta thërras mikun tim në telefon pastaj do të organizohemi mirë, - foli babai qetë.
  - Me të hollat e planifikuara për ditëlindjen tënde, ne do të mund të blejmë biletën, - shpjegoi nëna.
- Pupu sa nuk fluturonte nga gëzimi.









**Dhe ja tani Pupu ishte afër realizimit të dëshirës. Derisa po ngjitej shkallëve të aeroplanit me nxitim, Pupu po fliste me vete "Planifikimi i buxhetit qenka vërtet i rëndësishëm. Sapo të kthehem nga udhëtimi do të planifikoj buxhetin e vitit të ardhshëm".  
Babai i Leas po e percjellte pas me buzëqeshje.**













**Pupu dhe Lea po kënaqeshin me lojra në borë. Të qeshurat e tyre jehonin në qytet. - Ha, ha, ha! Sa kënaqësi! – dëgjohej zëri i Pupus duke u rrokullisur në dëborë.  
- Prite këtë tani, - thirri Lea duke ia hedhur një top bore Pupus.**







**Pupus nuk i pritej të shihte të gjithë në shtëpi dhe t'ju tregonte për të gjitha ato që kishte përjetuar. Ai ishte kujdesur që secilit t'i sjellë nga një dhuratë, nuk e kishte harruar as miushin.**

- Nënë, nënë, - thirri Pupu me zë të lartë nga gëzimi.**
- U ktheve bir? – e përqafoi fort nëna me mallëngjim.**
- Ju faleminderit! Ishte udhëtim i paharrueshëm. Dhuratë që do ta mbaj në mend gjatë, – foli Pupu duke i përqaftuar të dy prindërit.**





Titulli: "Një ditëlindje më ndryshe!"  
Hartoi tekstin: Luljeta Rama  
Ilustroi: Leopard Cana

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

0875

821.18-93-34

Rama, Luljeta

Një ditëlindje më ndryshe! / hartoi tekstin Luljeta Rama; ilustroi Leopard Cana. - Prishtinë:

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, 2020. - 20 f. : ilustr. ; 22 cm. - (Libri i katërt)

1.Cana, Leopard

ISBN 978-9951-8977-7-8

E drejta e autorit i përket Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nëse përdorni pjesë të këtij botimi, ju lutemi të citoni burimin.  
Realizimi i këtij libri u mbështet nga EFSE Departamenti për Zhvillim.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Adresa: Rr. Garibaldi, Nr. 33 Prishtinë, Kosovë.  
Tel: + 383 38 222 055  
Fax: +383 38 243 763  
e-mail: [info@bqk-kos.org](mailto:info@bqk-kos.org)





# Një ditëlindje më ndryshe!

**Pupu në garën e vrapimit**

**Pupu shkon në bankë!**

**A do të shkojë Pupu në cirk?**

**Një ditëlindje më ndryshe!**

**Pupu ka një ide!**

**Libri i katërt**

[www.edukimifinanciar.org](http://www.edukimifinanciar.org)

Edukimi financiar për nxënësit e klasave I-V

ISBN 978-9951-8977-7-8



9 789951 897778